



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe nenin 17 (me theks shkronjat i) dhe k) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, Ligjit nr.05/L-021 për mbrojtjen nga diskriminimi, Rregulloren (QRK) nr.03/2017 për mekanizmat institucional për mbrojtje nga diskriminimi në Qeveri dhe Komuna, dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 19 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18 si dhe duke u mbështetur në Strategjia dhe Plani i Veprimit për integrim të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2022-2026, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 04 mars 2024, mori këtë;

V E N D I M PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZI DHE MOS DISKRIMINIM NË KOMUNËN E PODUJEVËS 2024-2026

Neni 1

Me këtë vendim miratohet Plani Lokal i Veprimit për Barazi dhe Mos Diskriminim në Komunën e Podujevës për periudhën kohore 2024-2026

Neni 2

Plani Lokal i Veprimit për Barazi dhe Mos Diskriminim sipas këtij vendimi është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

Nën përkujdesjen e Kryetarit të Komunës, për zbatimin e këtij Vendimi respektivisht Planit Lokal të Veprimit për Barazi dhe mos Diskriminim në Komunën e Podujevës, kujdeset Zyra Komonale për Komunitete dhe Kthim në bashkëpunim dhe koordinim me Njësitin për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në Komunën e Podujevës, me Drejtorinë e Arsimit, si dhe Drejtoritë dhe njësitë / sektorët tjerë varësisht fushëveprimtarisë së tyre në kuadër të Komunës së Podujevës

Neni 4

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-944/01-0015799/24
Podujevë, datë; 04 mars 2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DRAFT
PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR BARAZI DHE MOS DISKRIMINIM NË
KOMUNËN E PODUJEVËS 2024-2026

04 mars 2024

Shkurtesat

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) është mekanizmi me bazën më të detajuar ligjore të zhvilluar përmes bashkëpunimit ndërmjet organeve të nivelit qendror që kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë, apo të tërthortë për çështjet e komuniteteve:

Buxheti i Konsoliduar i Kosovës BKK

Kuvendi Komunal Podujevë KKP

Drejtoria Komunale e Arsimit DKA

Drejtoria e Administratës DA

Drejtoria e Shendetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS

Drejtoria e Financave DF

Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik DPZHE

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje Hapsinor DPUMH

Drejtoria e Sherbimeve Publike DSHP

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport DKRS

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër DGJK

Policia e Kosovës PK

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës ZKM

Zyra për Komunitete dhe Kthim pranë Kryeministrit ZKK

Zyra për qeverisje të mirë, të drejta të njeriut, mundësi të barabarta dhe çështje gjinore ZQMTNJMBÇGJ

Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK),

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS),

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL),

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor (MAPH),

Ministria e Integritimit Europian (MIE),

Ministria e Drejtësisë (MD),

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB),

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT),

Ministria e Administratës Publike (MAP),

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI)

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE),

Ministria e Financave (MF)

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS)

Ministria e Diasporës (MeD)
Policia e Kosovës (PK)
Qendra për Punë Sociale (QPS)
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK)
Njësi për të Drejtat e Njeriut dhe Barazia Gjinore
Komiteti Komunal Veprues, Komuna e Podujevës

HYRJE

Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdon të jetë e përkushtuar në parimet e saj për një shoqëri demokratike, me të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët pa dallim etnike, feje, gjuhe, gjinie, moshe në bazë të legjislacionit të saj primarsi Kushtetuta e Kosovës dhe atyre ndërkombëtare. Qeveria e Kosovës shpreh përkushtimin dhe angazhimin e plotë në zbatimin e prioriteteve të “Strategjisë dhe Planit të Veprimit të integritetit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2022 – 2026” të cilat në të njëjtën kohë paraqesin përgjigje ndaj kërkesave të procesit të Stabilizimit dhe Asocimit. “Strategjia dhe Plani i Veprimit për integritet të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2022 – 2026” mbaron në vitin 2026, Prandaj Qeveria e Kosovës duke i kushtuar rëndësi të veçantë përmirësimit të pozitës së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në “Planin e dokumenteve strategjike të qeverisë për vitin 2022-2026” ka përfshirë edhe hartimin e planit të ri. Për realizimin e Planit të Veprimit Komuna e Podujevës, përkatësisht Zyra për Komunitete dhe Kthim në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim Europian OSCE, me pjesëmarrje të të gjitha drejtorive komunale, institucioneve të Sigurisë dhe Organizatave Joqeveritare që veprojnë në Podujevë ka hartuar Planin e ri të Veprimit 2023 – 2025. Ky plan ruan strukturën organizative të Planit të Veprimit të Qeverisë së Kosovës, rrjedhimisht ky plan është hartuar duke u bazuar me planin qeveritar duke gërshetuar të dhënat dhe specifikat që ka komuna e Podujevës.

Në bazë të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje ishte përpjekje e përbashkët e grupit punues për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit edhe për Planin Lokal të Veprimit për Barazi dhe mos Diskriminim në Komunën e Podujevës 2024-2026.

- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Planit të Veprimit Lokal për Barazi dhe mos Diskriminim. Është një nga dokumentet më të rëndësishme të Komunës së Podujevës, hartimi i të cilit ka ndjekur një proces të gjatë diskutimesh dhe kontributesh konkrete të institucioneve relevante që punojnë për këtë fushë për ta parandaluar diskriminimin dhe për të avansuar çdoherë për barazi dhe të drejtat e njeriut pa diskriminim.

METODOLOGJIA:

Procesi i hartimit të Planit Lokal të Veprimit për Barazi dhe mos diskriminimin në Komunën e Podujevës për vitin 2023-2026.

Në përgjithësi ky Plan Veprimi është hartuar në përputhje me sugjerimet, kërkesat dhe kontributet e përfaqësuesve të ndryshëm nga Komuna e Podujevës, Komiteti Komunal Veprues si dhe përfaqësues të OJQ-ve dhe grupeve avokuese që merren me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore që merren me grupet e cenushme për barazi dhe të drejtat e tyre.

Ku rolin kryesor e ka Njësiti për të Drejtat e Njeriut dhe Barazia Gjinore.

* Pas themelimit të Komitetit Komunal Veprues dhe grupeve punuese nga Komuna janë zhvilluar disa takime konsultative dhe tri punëtori për hartimin e këtij Plani Lokal të Veprimit.

* Për të avansuar edhe më tutje përfshirjen në këtë Plan të Veprimit kontribut kanë dhënë edhe OJQ-të vendore që vijnë nga komunitetet jo-shumicë siç janë: OJQ “Qëndrimi”, OJQ “Një hap me ne” dhe OJQ “Shpresa Demokratike”.

* Po ashtu është angazhuar edhe OSBE-ja e cila ka përkrahur dhe ndihmuar me këshilla dhe mbështetje në facilitimin e punëtorëve për këtë plan të veprimit për barazi dhe mos diskriminim në të gjitha fushat e jetës.

VIZIONI DHE MISIONI:

* Komuna e Podujevës ka përcaktuar vizionin e saj për avansimin e pozitës së komuniteteve jo-shumicë dhe të gjitha grupeve të cënueshme duke krijuar një ambient të përshtatshëm social, ekonomik, arsimor, shëndetësor, pronësor etj, që mundëson zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe përmbushë standartet më të larta të të drejtave të njeriut.

*** MISIONI:**

Në fokus të arritjes së këtij vizioni, Komuna ka përcaktuar edhe misionin e saj që të siguroj zbatimin e legjislacionit në fuqi i cili siguron qasje të barabarta për të gjitha komunitetet si në arsim, punësim, shërbime shëndetësore, sociale, pronësore, strehim, banim, infrastrukturë, pa diskriminim duke bashkëpunuar ngusht me të gjitha strukturat e qytetarëve e sidomos me grupet e cënueshme (gjinia, mosha, grupet e marginalizuara, njerëzit me nevoja të veçanta).

* Të ketë fushatë informuese për mënyrën e raportimit të rasteve të diskriminimit, racizmit, ngacmimit, gjuhës së urrejtjes dhe bullizmit.

DISKRIMINIMI:

* Diskriminimi mund të jetë prezent në gjithë popullatën, sidomos në aspektin e barazisë gjinore dhe grupeve të cënueshme, që në situata shoqërore ndihen të diskriminuar për shkak të gjendjes së tyre, qoftë në aspektin socio-ekonomik, gjinor, identitet kombëtar, religjioz, gjuhësorë, racor, politik etj.

* Prandaj ky fenomen kërkon trajtim më afatgjatë dhe koordinim të mirë me të gjitha institucionet komunale, qendrore, OJQ-të, shoqëria civile, mediat etj.

* Informimi më i saktë për të ditur gjendjen më reale që merren nga institucionet të cilat merren drejtpërdrejt me këto çështje siç janë: Njësi për të Drejtat e Njeriut, Barazia Gjinore, ZKKK-ja, QPS-ja etj janë edhe vizitat në terren duke vizituar vendbanimet e ndryshme dhe intervistat që kemi bërë me shumë prej tyre.

* Duke parë analizat e situatës së përgjithshme si dhe realizimin e një varg takimeve konsultative në të cilat kanë qenë të përfshirë institucionet përgjegjëse dhe akterët relevantë që punojnë në nivel lokal.

* Gjatë kësaj faze janë mbajtur takime individuale dhe grupore për t'u njohur më mirë për të drejtat e njeriut.

* ZKKK-ja ka aplikuar metodat dhe teknikat të përdorura për hartimin e Planit të Veprimit për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për vitin 2023-2026.

* Janë praktikuar punime në grupe dhe hulumtime përmes pyetësorëve.

* Fokus grupet kanë pasë qëllim nxjerrjen e nevojave imediate nga komunitetet jo-shumicë duke ballafaquar mendimin e tyre, kjo ka ndihmuar ta dimë gjendjen reale në terren.

Për të drejtat e barabarta dhe mundësitë e barabarta ky parim njih nevojën që pjesëtarët nga radhët e komuniteteve jo-shumicë dhe grupet e cënueshme të kenë mundësi të barabarta në të gjitha fushat e shoqërisë për të gjithë qytetarët pa dallim.

* Parimi i mos diskriminimit bazohet të merren të gjitha masat që sigurojnë, që në mënyrë të konsiderueshme të zvogëlohet shkalla e diskriminimit ndaj grupeve të cënueshme.

* Për hartimin e këtij plani përpos institucioneve lokale, rol të rëndësishëm dhe baza e përfaqësimit

* Zyra e Kryeministrit (ZQM, ZÇK, ABGJ, Zyra Ligjore, Zyra e Financave), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia për Regjistrim Civil, Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, IKAP – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Agjencia e Punësimit,

Ministria e Shëndetësisë, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Akademia e Drejtësisë, si dhe një varg OJQ vendore dhe ndërkombëtare.

* Pas kalimit të fazave të mësipërme dhe procesit të konsultimeve paraprake dhe konsultimeve publike janë marrë parasysh edhe proceset e konsultimeve paraprake dhe konsultative.

* Janë përfshirë në versionin final të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër dhunës në familje dhe Planit Lokal të Veprimit për Barazi dhe mos Diskriminim.

* Hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit është përkrahur nga Këshilli për Koordinim Rajonal për Integrimin e Komuniteteve dhe grupeve të cenushme (RCC) Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë OSBE si dhe OJQ-të vendore.

* **Sfidat kryesore:**

Nga analiza e gjendjes që është bërë në shumë fusha të rëndësishme siç janë: arsimi, shëndetësia, punësimi, mirëqenia sociale, ekonomike, banimi, strehimi, prona, shprehja e lirë, demokracia, gjinia, identiteti kombëtarë, religjioz, gjuhësor, racor, politik etj.

DISKRIMINIMI – Diskriminimi në bazë të etnisë për Komunitetet jo-shumicë dhe grupeve të cenushme në bazë të strategjisë për arritjen e objektivave, parasheh zhvillimin dhe zbatimin e politikave gjithëpërfshirëse në të gjitha fazat dhe nivelet e politikave, programeve dhe projekteve, ku do të ndikojnë në luftimin e racizmit dhe diskriminimit ndaj Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në mënyrë sistematike dhe në rritjen e cilësisë së jetës për komunitetet jo-shumicë, si në arsim, punësim, mirëqenie sociale, shëndetësi, banim, strehim, infrastrukturë dhe të gjitha sferat tjera të jetës.

Që ndikojnë në mënyrë sistematike përmes Zhvillimit Ekonomik dhe zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse në të gjitha fazat dhe nivelet e politikave dhe programeve për mirëqenie sa më të mirë për të gjithë qytetarët e sidomos për banorët e Komuniteteve jo-shumicë në Komunën tonë.

* **Diskriminimi dhe Siguria Njerëzore**

* Një ndër qëllimet kryesore të sigurisë njerëzore është ofrimi i kushteve të gjithë njerëzve për shfrytëzimin dhe zgjerimin e mundësive, zgjedhjeve dhe aftësive të tyre, duke qenë të lirë nga pasiguria.

* Diskriminimi i bazuar në çfarëdo baze, pengon njerëzit që në mënyrë të barabartë të ushtrojnë të drejtat dhe zgjedhjet e tyre dhe kjo rezulton jo vetëm në pasiguri ekonomike dhe shoqërore, por gjithashtu prek edhe vetërespektin dhe vetëvendosjen e personit të diskriminuar, gjithashtu diskriminimi racor dhe shkelja e të drejtave të anëtarëve të grupeve të nënshtuara të minoriteteve, paraqet jo

stabilitet shoqëror.

* Njohja e dinjitetit të lindur dhe të drejtave të barabarta, ashtu siç është deklaruar në Preambulën e Deklaratës Univerzale për të Drejtat e Njeriut, të gjithë pjesëtarëve të familjes, paraqet shtyllën për liri, drejtësi dhe paqe në botë.

* Prandaj, tejkalimi de facto i pabarazive të bazuara në racë, gjini, identitet kombëtar, religjion, gjuhë dhe kushtet tjera sociale, ekonomike, duhet të jenë prioritetete të larta në agjendën e sigurisë njerëzore.

* Në përgjithësi, diskriminimi konsiderohet çdo formë e dallimit, përjashtimit, kufizimit ose ndonjë preferim, me qëllim të mohimit ose refuzimit të të drejtave të barabarta dhe mbrojtjes si dhe paraqet mohim të parimit të barazisë ndaj dinjitetit njerëzor.

* Varësisht nga arsyetja për trajtim të tillë, ne mund të flasim për diskriminim në baza racore, kombëtare, ngjyre, gjinie, religjioni etj.

* Është shumë e rëndësishme të dihet se nuk mund të konsiderohet çfarëdo dallimi menjëherë edhe si diskriminim në kuptimin e abuzimit të të drejtave të njeriut.

Përderisa ky dallim është i bazuar në kriteret e arsyeshme dhe objektive, ai mund të justifikohet.

* Njihet edhe diskriminimi pozitiv, ose ndryshe quhet veprim pozitiv, që është praktikuar nga institucionet qeverisëse të Komunës së Podujevës për Komunitetet pakicë.

* Masat e veprimeve pozitive kanë qenë çdoherë të përkrahura, për favorizimin e komuniteteve jo-shumicë me qëllim të kompozimit të pabarazive të mëhershme për integrimin e tyre në të gjitha fushat e jetës dhe për një stabilizim socio-ekonomik dhe për mbrojtjen nga diskriminimi dhe të drejtat e tyre për të gjithë qytetarët.

* Në kuadër të institucioneve të Komunës është edhe zyrtarja përgjegjëse për mbrojtjen nga diskriminimi.

EDUKIMI; MASAT MBROJTËSE

- * Vijimi i ulët në edukimin parafillorë
- * Respektimi i ligjit mbi shkollimin e obliguar
- * Koordinimi i politikave dhe aktiviteteve DKA
- * Koordinimi mes institucioneve dhe shoqërisë civile (OJQ-ve)
- * Regjistrimi me kohë në klasën e parë
- * Mosbraktisja e shkollës fillore
- * Sigurimi i rrugëve, trotuareve, për në shkollë

- * Braktisja e shkollës së mesme
- * Numri i madh i të rriturve pa shkollim fillor dhe të mesëm
- * Zhdukja e analfabetizmit
- * Masat për riintegrimin në shkolla i nxënësve të riatdhesuar
- * Rezultatet jo të mira në testet e klasave 5 dhe 9
- * Rezultate jo të mira në testet e përfundimit të shkollës së mesme
- * Numri jo i mirë i personave që nuk përfundojnë shkollimin e mesëm
- * Informimi sa më i mirë për arsimin e komuniteteve jo-shumicë dhe grupeve të cënueshme
- * Mos paragjykimet dhe stereotipet e pjesëtarëve të komuniteteve tjera etnike ndaj këtyre komuniteteve
- * Përfshirja e komuniteteve në aktivitetet jashtë mësimore kulturore-sportive
- * Mbështetja financiare e qendrave mësimore, për mësim-nxënie shtesë
- * Ofrimi i mësimi plotësues për nxënësit që kanë ngecje në mësim
- * Involvimi i dobët i prindërve
- * Mungesa e mësimdhënësve nga radhët e Komuniteteve për mësim plotësues për nxënësit që kanë ngecje në mësim
- * Promovimi i vlerave, trashëgimia dhe identiteti i komuniteteve
- * Bashkëpunimi më i mirë mes DKA-së, shkollës dhe prindërve
- * Situata jo e mirë socio-ekonomike

PUNËSIMI DHE MIRËQENIA SOCIALE; SFIDAT KRYESORE:

- * Niveli mesatarisht më i ulët i shkollimit
- * Mosqasja në informata rreth punësimit
- * Mos regjistrimi në Entin e Punësimit
- * Mosrespektimi i Ligjit për Punësim
- * Nuk ka trajnime të mjaftueshme profesionale për punë
- * Të informohen për trajnime profesionale
- * Mos interesimi të marrin pjesë në trajnime
- * Informimi rreth skemave të mbrojtjes sociale
- * Informimi për regjistrim civil
- * Informimi rreth kuadrove për punë

- * Informimi dhe qasja e institucioneve përkatëse komunale rreth fëmijëve me nevoja të veçanta
- * Informimi rreth skemave të mbrojtjes dhe shërbimeve sociale
- * Bashkëpunim mes OJQ-ve dhe institucioneve
- * Bashkëpunim mes QPS – Enti i Punësimit dhe Institucioneve Komunale
- * Krijimi i besimit të komuniteteve jo-shumicë dhe grupeve të cenueshme në institucionet publike
- * Rekomandim: që të ndërmerren masa nga institucionet publike për zhvillimin e projekteve për aftësim profesional të pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë në fusha dhe profesione që ka nevojë tregu i punës

SHËNDETËSIA DHE SFIDAT:

- * Informimi sa më i mirë në shërbimet parandaluese dhe kurative shëndetësore
- * Varfëria dhe pamundësia për pagesën e trajtimit dhe blerjes së barnave në sektorin sekondar dhe terciar
- * Mungesa e dokumenteve të identifikimit
- * Paraqitja e vonueshme tek mjeku
- * Besueshmëria tek mjekët dhe pesoneli tjetër mjekësor
- * Të ushqyerit joadekuat dhe të pamjaftueshëm
- * Krijimi i kushteve për higjienën e përgjithshme dhe individuale
- * Mos vaksinimi i fëmijëve
- * Vizitat e mjekut në shtëpi për kujdes ndaj nënave dhe fëmijëve
- * Bashkëpunimi më i mirë me OJQ-të
- * Të jetë informimi sa më i mirë për shëndetin dhe të ketë trajnime kundër dukurive deviante, duhanit, drogës, pijeve alkoolike etj.

STREHIMI, SFIDAT:

- * Mungesa e të dhënave të dokumenteve pronësore
- * Mungesa e pronave të legalizuara nga familjet e komuniteteve jo-shumicë
- * Krijimi i vendbanimeve jo-formale
- * Mungesa e mjeteve financiare për ndërtimin e shtëpive për familjet në nevojë
- * Mungesa e dokumentacionit nga pronari

- * Përmirësimi i kushteve, renovimi i shtëpive ekzistuese
- * Mundësia e ndarjes së ndonjë parcele për ndërtimin e shtëpive për ato familje të pastrehë që nuk kanë pronë
- * Legalizimi i pronave ekzistuese bartja e pronës në emër të pronarit
- * Gatishmëria e donatorëve për ta përkrahur Komunën për zgjedhjen e shumë familjeve në nevojë për banim
- * Mungesa e fondeve qeveritare për mbështetjen e banimit për komunitetet jo-shumicë dhe familjet tjera në nevojë

ZBATIMI I PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZI DHE MOS DISKRIMINIM

I. Arsimi				
Qëllimi: Ndërtimi i sistemit arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës të bazuar në drejtësi, barazi dhe respekt për diversitetin që i kontribuon integritet të plotë të komuniteteve Rom, Ashaklinjë dhe Egjiptian në shoqëri.				
Objektivi 1: Përmirësim i dukshëm i pjesëmarrjes në arsim dhe i cilësisë së arsimit për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë				
Aktiviteti 1: Përfshirja e edukatorëve Rom, Ashaklinjë dhe Egjiptian dhe asistentëve të tyre në nivelin parafillor dhe parashkollor.		Periodha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 1.1 Hulumtimi i nevojave për arsimimin parafillor dhe parashkollor dhe krijimi i kushteve për pjesëmarrje	2024 d --	DKA,ZKKK	BKK, donatorë
2	Veprimi 1.2 Identifikohen edukator të kualifikuar dhe asistentet nga radhet e komuniteteve jo shumicë	2024	DKA,ZKKK	BKK
3	Veprimi 1.3 Kycja në sistemin arsimor të personelit të identifikuar	2024	DKA,ZKKK	BKK
4	Veprimi 1.4 Publikimi i raportit hulumtues	2024	DKA,ZKKK	BKK

Aktiviteti 2: Ofrimi i programeve ri-integruese për fëmijët e kthyer nga diaspora		Periodha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 2.1 Identifikohen familjet e kthyer nga jashtë	Vazhdimisht	ZKKK,DKA	BKK
2	Veprimi 2.2 Ofrohen kurse gjashtëmujore për gjuhën e vendit	Vazhdimisht	ZKKK,DKA	BKK
3	Veprimi 2.3 Ofrohen tekste dhe materiale shkollore falas për nxënës	Vazhdimisht	ZKKK,DKA	BKK
4	Veprimi 2.4 Nostrifikohen dokumentacionet shkollore	Vazhdimisht	ZKKK,DKA	BKK
5	Veprimi 2.5 Publikimi i të dhënave mbi nxënësit e riintegruar në shkolla , kurset e mbajura , testet shkollore të shpërndara	Vazhdimisht	ZKKK,DKA	BKK

Shënim: BKK-Buxheti i konsoliduar i Kosovës, për këto veprime ndahen fonde nga MASHT-i

Aktiviteti 3: Motivimi për pjesëmarrje të shtuar në arsim		Periudha	Bartës	Buxheti
		1	Veprimi 3.1 Organizimi i fushatës së ndërgjegjësimit për prindër për regjistrimin me kohë të fëmijëve në shkollë	2024 -2026
2	Veprimi 3.2 Identifikohen nevojat e nxënësve që nuk vijnë në mësimin me rregull	Vazhdimisht	DKA-ZKKK	BKK
3	Veprimi 3.3 Ofrohen programe mësimi joformale intensive për nxënësit që kanë braktisur shkollën në nivelin fillor dhe të mesëm	Vazhdimisht	DKA-ZKKK	BKK
4	Veprimi 3.4 Ofrohen tekste dhe materiale shkollore falas	Vazhdimisht	DKA-ZKKK	BKK
5	Veprimi 3.5 Ofrohen orë plotësuese në shkollat për gjuhë rome dhe lëndë tjera të nevojshme nëse ka.	Vazhdimisht	DKA	BKK
6	Veprimi 3.6 Caktohen mësimdhënësit që punojnë me nxënësit me vështirësi në të nxënë përkatësisht në orë plotësuese	2024		

Aktiviteti 4. Krijimi i kushteve për vazhdimin e arsimit pas shkollimit të obligueshëm		Periudha	Bartës	Buxheti
		1	Veprimi 4.1 Themelimi i fondit për bursa	2024
2	Veprimi 4.2 Themelimi i komisionit të përbashkët të përbërë prej komuniteteve, institucioneve dhe organizatave për ndarjen e bursave	2024	DKA-ZKKK-OJQ	BKK
3	Veprimi 4.3 Organizohen fushata ndërgjegjësimi për vazhdimin e shkollimit	2024-2026	DKA-ZKKK-OJQ	BKK
4	Veprimi 4.4 Ofrohen kurse përgatitore gjatë vitit shkollos për regjistrim në shkollën e lartë, për nxënësit me rezultate të dobëta	2024-2026	DKA-ZKKK	BKK

Aktiviteti 5. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin e rregullt arsimor		Periudha	Bartës	Buxheti
		1	Veprimi 5.1 Identifikohen fëmijët me nevoja të veçanta	2024 dhe vazhdimisht
2	Veprimi 5.2 Raportimi dhe koordinimi i punës me MASHT-in për veprimet e mëtutjeshme	Vazhdimisht	DKA	BKK

Aktiviteti 6. Parandalimi i sergregacionit dhe diskriminimit me akte ligjore		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 6. Raportimi i shkollave për rastet e raportuara të sergregacionit ose anashkalimit	Vazhdimisht	DKA	BKK
2	Veprimi 6.2 Adresim dhe zgjedhje e rasteve të raportuara	Vazhdimisht	DKA	BKK
3	Veprimi 6.3 Në bashkëpunim me MASHT-in, ofrohen trajnime për mësuesin për mënjanimin e paragjyqimeve	Vazhdimisht	DKA-MASHT	BKK

Objektivi 2: Bashkëpunim cilësor dhe efikas në mes të institucioneve dhe organizata relevante në funksion të arsimit të pjestarëve të komuniteteve Rom , Ashkali dhe Egjiptian				
Aktiviteti 1: Aktivitete të përbashkëta me policinë e komunitetit lidhur me sigurinë		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 1.1 Bashkëpunim me Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.	2024-2026	DKA-ZKKK	BKK
2	Veprimi 1.2. KKSBB identifikon rastet që kanë të bëjnë me cenimin e sigurisë së nxënësve në shkolla	Vazhdimisht	DKA	BKK
3	Veprimi 1.3 DKA lidh marrëveshje bashkëpunimi me policinë e komunitetit lidhur me ofrimin e sigurisë së nxënësve në shkolla. Element të marrëveshjes janë patrullimi i rregullt, në afërsi të shkollave.	2024 Vazhdimisht	DKA-PK	BKK
4	Veprimi 1.4 DKA, shkollat dhe policia e Kosovës hartojnë planin e veprimit	2024-2026	DKA-PK	BKK
5	Veprimi 1.5 Mbahen takime të rregullta tremujore në mes DKA-shkollave , PK dhe përfaqësuesve të komuniteteve.	Vazhdimisht	DKA-ZKKK-PK	BKK
6	Veprimi 1.6 Hartohen dhe publikohen raportet tremujore	Vazhdimisht	DKA-PK	BKK

Aktiviteti 2. Masat për mosrespektim të Ligjit mbi shkollimin e obliguar		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 2.1 Identifikohen nxënësit që kanë braktisur shkollën dhe që nuk vijojnë shkollën rregullisht	vazhdimisht	DKA-ZKKK	BKK
2	Veprimi 2.2 Organizohen takime informative me komunitete në lidhje me detyrimet ligjore mbi arsimin e obliguar	2043-2026	DKA-ZKKK	BKK
3	Veprimi 2.3 Ndërmerren masa ligjore ndaj stafit të shkollës që nuk raporton me kohë rastet e braktisjes dhe mosvijueshmërisë.	vazhdimisht	DKA	BKK

Aktiviteti 3: Ofrohen programe ekzistuese për zvogëlimin e shkollës së analfabetizimit - përkrahje				
		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 3.1 Identifikohen partnerët që ofrojnë programe të licensuara kundër analfabetizimit	2024	DKA-ZKKK	
2	Veprimi 3.2 Identifikohen individët që nuk kanë vijuar shkollën	2024	DKA-ZKKK	
3	Veprimi 3.3 Organizohen takime me grupet e identifikuara me qëllim të informimit për mundësitë lidhur me zhdukjen e analfabetizimit	2024	DKA-ZKKK	
4	Veprimi 3.4 Në kuadër të qendrave të komunitetit të organizohen kurse vetëm për femra	2024	DKA-ZKKK	

Aktiviteti 4: Krijimi i qendrës burimore në nivel komunal				
		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 4.1 Ofrohen orë plotësuese për nxënësit e shkollave fillore	Vazhdimisht	DKA-ZKKK	
2	Veprimi 4.2 Kurse të ndryshme për pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkalinje dhe egjiptian	Vazhdimisht	DKA-ZKKK	
3	Veprimi 4.3 Ofrojnë programe për zhdukjen e analfabetizimit	Vazhdimisht	DKA-ZKKK	
4	Veprimi 4.4 Përfshirja e prindërve në aktivitete të Qendrës.	Vazhdimisht	DKA-ZKKK	
5	Veprimi 4.5 Krijimi i këshillit të prindërve të nxënësve nga radhët e komuniteteve rom, ashkalinjë dhe egjiptian	Vazhdimisht	DKA-ZKKK	
6	Veprimi 4.6 ZKKK lehtëson koordinimin e punëve të KPNRAE me KPA	Vazhdimisht	DKA-ZKKK KPA	

Këshilli i prindërve të Nxënësve të Komuniteteve ROM, Ashkali dhe Egjiptian

Këshilli i prindërve dhe arsimtarëve

Aktiviteti 5: Organizohen aktivitete kulturore sportive				
		Periodha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 5.1 Formohet grupi kulturor i shkollës në përbërje të mësimitdhënësve , nxënësve dhe prindërve		DKA-shkolla ZKKK	Nuk kërkohen
2	Veprimi 5.2 Formohen grupet sportive në shkollë në formë të klubeve sportive	2024	DKA-shkolla ZKKK	Nuk kërkohen
3	Veprimi 5.3 Hartohet plani shkollor për aktivitete kulturore dhe sportive me karakter multi-etnik	2024	DKA-shkolla grupet e formuara	Nuk kërkohen
4	Veprimi 5.4 Caktohen përgjegjësit për realizimin e aktiviteteve sipas planit të hartuar		DKA-shkolla grupet e formuara	
5	Veprimi 5.5 Caktohet buxheti për aktivitete e parapara në planin e hartuar		DKA-shkolla grupet e formuara	
6	Veprimi 5.6 Organizohen aktivitetet kulturore në përputhje me interesat e komunitetit	vazhdimisht në bazë të planit të hartuar	DKA-shkolla grupet e formuara	DKRS, DKA

SHËNDETËSIA

Qëllimi: Përmirësimi i statusit shëndetësor dhe social, dhe cilësisë së shërbimit dhe qasjes ndaj sistemit shëndetësor dhe social të Kosovës, pa diskriminim të tri komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Objektivi 1: Krijimi i kushteve cilësore dhe të qëndrueshme higjeno-sanitare dhe mjedis i përshtatshëm dhe i shëndetshëm në vendbanimet e komuniteteve jo shumicë

Aktiviteti 1: Ndërmarrja e aktiviteteve për përmirësimin e kushteve higjeno-sanitare , të mjedisit dhe praktikave dhe sjelljeve relevante		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 1.1 Sigurimi i ujit të pijshëm, kanalizimeve dhe vendeve të caktuara për hedhjen e mbeturinave dhe të rrjetit elektrik në lagjet e Komuniteteve jo shumicë	vazhdimisht	Komuna ZKKK- MPMS	
2	Veprimi 1.2 Ofrimi i programeve trajnuese dhe edukative për shëndetin dhe higjenën personale	vazhdimisht	ZKKK- DSHMS	
3	Veprimi 1.3 Institucionalizimi i pozitës së ndërmjetësit shëndetësor		DSHMS,ZKK 2024 K ,OJQ-të	

Objektivi 2: Mundësimi i marrjes së shërbimeve sociale përmes ndarjes së informacionit, përfshirjes në skemat e ndihmës dhe ofrimit të shërbimeve në formë të barabartë dhe në përputhje me nevojat

Aktiviteti 2. Ofrimi i shërbimeve sociale përmes ndërgjegjësimit, informimit dhe përfshirjes në skemat ekzistuese.		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 2.1 Informimi i komuniteteve për mundësitë e marrjes dhe llojeve të shërbimeve	vazhdimisht	ZKKK-QPS	
2	Veprimi 2.2 Ofrimi i ndihmave sociale për komunitetet jo shumicë	vazhdimisht	MPMS	BKK
3	Veprimi 2.3 Lehtësime në obligimet komunale për familjet që nuk kanë ndihmë sociale dhe asnjë formë tjetër të të ardhurave	vazhdimisht	ZKKK	

Objektivi 3: Vlerësimi i kushteve i dijenisë shëndetësore të tri komuniteteve përmes mbledhjes dhe analizës së të dhënave të qëndrueshme dhe të besueshme.				
Aktiviteti 3:Përmirësimi i qasjes së tri komuniteteve ndaj sistemit shëndetësor dhe përdorimit efektiv të tij përmes informimit dhe fushatave ndërgjegjësuese				
		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprim 3.1 Mbajtja e fushatave për imunizim, sistemit shëndetësor, riciklimin e mbeturinave etj.	vazhdimisht	DSHMS-QKMF-ZKKK	
2	Veprimi 3.2 Mbajtja e takimeve në komunitete për informim dhe rritjen e dijenisë mbi të drejtat për shërbimet e ofruara mjekësore	vazhdimisht	DSHMS-QKMF-ZKKK	
3	Veprimi 3.3 Vaksinimi i detyrueshëm i të gjithë fëmijëve nga mosha 0-14 vjeç	vazhdimisht	DSHMS-QKMF-ZKKK-OJQ	
4	Veprimi 3.4 Trajnimi dhe aftësimi i nënave për një kujdes të shtuar gjatë kohës së shtatzanisë, kontrollave të rregullta mjekësore.	vazhdimisht	DSHMS-QKMF-ZKKK	
5	Veprimi 3.5 Të jetë kujdes parësor për nënat dhe fëmijët para, gjatë dhe pas lindjes	vazhdimisht	DSHMS-QKMF-ZKKK	

Objektivi 4: Krijimi i kushteve cilësore dhe të qëndrueshme higjeno-sanitare dhe mjedis i shëndetshëm në vendbanimet e komuniteteve jo shumicë				
Aktiviteti 4:Përmirësimi i qasjes së tri komuniteteve ndaj sistemit shëndetësor dhe përdorimit efektiv të tij përmes informimit dhe fushatave ndërgjegjësuese				
		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprim 4.1 Të mbahen takime sistematikisht në edukimin shëndetësor në grupe dhe bashkësi si dhe në sigurimin e kushteve dhe praktikave tjera në kontest të ruajtjes së shëndetit dhe qasje të ekipeve mjekësore ndaj komuniteteve gjithëherë kur kanë qenë të nevojshme	vazhdimisht	DSHMS-QKMF-ZKKK-OJQ-të	

2	Veprimi 4.2 Vazhdimisht të mbahen trajnime dhe fushatë për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në kujdesin primar, në imunitet në trajtimin e sëmundjeve dhe parandalimin e anemive dhe infeksioneve, parazitëve të zorrëve, tuberkulozit dhe sëmundjeve tjera ngjitëse.	vazhdimisht	DSHMS- QKMF-ZKKK- OJQ-të	
---	--	-------------	--------------------------------	--

3	Veprimi 4.3 Duhet pasur vazhdimisht trajnime dhe përgatitje rreth plotësimit të njohurive rreth higjenës personale dhe kolektive të të ushqyerit , higjenës dhe ruajtjes së ushqimit	vazhdimisht	DSHMS- QKMF-ZKKK- OJQ-të	
4	Veprimi 4.4 Trajtimi i shërbimit epidemiologjik për kontrollimin e ujit të pijshëm dhe marrjen e masave në parandalimin e ndotjes së ambientit për të gjithë qytetarët	vazhdimisht	DSHMS- QKMF-ZKKK- OJQ-të	
5	Veprimi 4.5 Të mbahen fushata dhe trajnime nëpër shkolla përmes personelit shëndetësor për parandalimin e dukurive devijante -negative siç janë; prostitucioni, droga, alkooli, duhani dhe tjera.	vazhdimisht	DSHMS- QKMF-ZKKK- OJQ-të	
6	Veprimi 4.6 Çdoherë të bëhet monitorimi i fëmijëve që mos të punojnë punë të rënda dhe të rrezikshme për shëndetin siç janë; punë me hekurishta, pesticide etj.	vazhdimisht	DSHMS- QKMF-ZKKK- OJQ-të	
7	Veprimi 4.7 Mbajtja e fushatave për ndërgjegjësimin dhe vetëdijen që të ulet numri i martesave në moshë re.	vazhdimisht	DSHMS- QKMF-ZKKK- OJQ-të	

Punësimi, mirëqenia sociale;

Qëllimi: Punësimi dhe përmirësimi i situatës ekonomike për të gjithë anëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Objektivi1 :Rritje e nivelit të punësimit të individëve nga komuniteti jo shumicë , përmes ndërmjetësimit ,aftësimit profesional dhe punësimit në sektorin publik dhe privat

Aktiviteti 1:Hartimi dhe zbatimi i programeve të reja dhe eksistuese për aktivizimin e krahut të lirë të punës nga të tri komunitetet jo shumicë

		Periodha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 1.1 Punësimi i anëtarëve të tri komuniteteve në sektotrin publik sikur që është paraparë në Ligjin për shërbyesit civil	Vazhdimisht	MAPL Komuna ,ZKKK	BKK
2	Veprimi 1.2 Punësim ekskluziv për komunitete jo shumicë në fushën e ndërtimtarisë dhe të infrastrukturës, në përmirësim të kushteve të banimit në vendbanimet ku banojnë edhe pjestarët e komuniteteve jo shumicë	Vazhdimisht	Komuna DPUMH, ZKKK- MPMS	
3	Veprimi 1.3 Përfaqësim më i madh në sektorin publik në nivel lokal.	Vazhdimisht	Të gjitha institucione t publike	
4	Veprimi 1.4 Publikimi i raportit hulumtues	Vazhdimisht	D. për Admin- istratë, ZKKK	

Qëllimi 2 : Rritja e numrit të të punësuarve nga komunitetet jo shumicë në sektorin privat, ekonomik përmes hartimit dhe zbatimit të politikave aktive fiskale - ekonomike që nxisin punësimin dhe vetpunësimin. Hartimi dhe zbatimi i politikave për vetëpunësim të anëtarëve të tri komuniteteve përmes mbështetjes së ndërmarrjet të vogla dhe të mesme, privatizimit dhe iniciativave fiskale				
Aktiviteti :Hartimi dhe zbatimi i programeve të reja dhe ekzistuese për aktivizimin e krahut të lirë të punës nga të tri komunitetet jo shumicë		Periodha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 2.1 Ndërmerren masa konkrete për zbutjen e taksave, tatimeve ndaj bizneseve të ndërrmarra nga tri komunitetet (p.sh. Lirimi nga taksta në dy vitet e para të biznesit etj.).	2024-2026	ZQK, ZQM, ZKM, NJDNI, OJQ shoqatave e bizneseve, Oda Ekonomike KosovësZyra e Tatim taskave Zyra për Barazi Gjinore , MPMS , MKK, BE ,ZKKK, DPZHE	BKK,
2	Veprim2.2 Mbahen takime të rregullta dhe nënshkruhen memorandume bashkëpunimi, mirëkuptimi mes Agjensisë Kosovare për Mbështetjen e Ndërrmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe institucioneve të kreditimit dhe mikrofinancave, për inkurajimin e biznesve nga anëtarët e tri komuniteteve.	Vazhdimisht	MEF, MAPL, MPMS, DBF, ZKKK donatore tjere,	BKK, donator tjerë
3	Veprimi 2.3 Krijohen programe specifike për qasje ndaj sektorit privat të cilat marrin parasysh veqoritë e tri komuniteteve	Vazhdimisht	MPMS, MEF, Komuna , ZKKK	
4	Veprimi 2.4 Realizohen trajnime me temën si të themelohet dhe zhvillohet afarizmi privat vetpunësimi i planifikuar nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale për zbatimin e Strategjisë për aftësimin e ndërmarrësit.	Vazhdimisht	MEF, MPMS, ZKKK, donator tjere	

5	Veprimi 2.5 Inkurajohen donatorët dhe institucionet e kredidhënies, të promovimit të biznesit dhe të mikro-financës të rriten në baza periodike fondet për biznese private dhe programe trajnuese për menaxhimin dhe këshillimin për anëtarët e tri komuniteteve	Vazhdimisht	MEF, MPMS, DBF,ZKKK, donator tjere	Donator tjerë
6	Veprim 2.6 Prodhimet e biznesit nga të tri komunitetet u krijohen mundësitë e prezenimit të tyre në panaiet e organizuara.	Vazhdimisht	Komuna, ZKKK, MPMS, OJQ- të	Donator tjerë
7	Veprimi 2.7 Krijohen programe dhe mbështeten programe specifike për femrat e tri komuniteteve për veprimtaritë e bizneseve.	Vazhdimisht	MEF, MPMS, Komuna, DBF, DPZHE, ZKKK ,OJQ- te	Donator tjerë
8	Veprimi 2.8 Mbajtja e një studimi mbi ekonominë informale të tri komuniteteve dhe shqyritimi i mundësive për kthimin e saj në ekonomi formale	Vazhdimisht	Komuna , DPZHE, DBF,ZKKK	BKK, donator tjerë

Objektivi 3: Inkurajim, përgatitje dhe mbështetje për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian për përfshirjen e tyre maksimale në aktivitete agrokulturore.				
Aktiviteti 3: Identifikimi dhe përzgjedhja e individëve nga tri të komunitetet të interesuar për të përfituar nga fondi I projekteve të MBPZHR, në fushën e mëposhtme, Bujqësi, Blegtori, Pemtari , Perime , Bletari etj.		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 3.1 Mbajtje e vizitave për informim mbi fondet e MBPZHR-së me komunitete Jo shumicë.	2024	Komuna ,ZKKK, DBPZHR, MBPZHR, OJQ -të	
2	Veprimi 3.2 Identifikimi I individëve ose grupeve të interesuara për të përfituar nga fondi i MBPZHR-së	Vazhdimisht	Komuna ,ZKKK, DBPZHR, MBPZHR, OJQ -të	
3	Veprimi 3.3 Stimulimi I individëve me të ardhura të ulëta, grave, familjeve me shumë anëtarë përmes vlerësimit të situatës ekonomike të të interesuarve për përfitime subvencioneve të ndryshme	Vazhdimisht	Komuna,DB F ,ZKKK, DBPZHR, MBPZHR, OJQ -të	Komuna , BKK, Donatorë tjerë
4	Veprimi 3.4 Ofrimi I ndihmës së duhur për përfitimin dhe përdorimin maksimal të fondeve nga ana e tri Komuniteteve (në veçanti ngritja e kapaciteteve të OJQ-ve nga këto tri komunitete me synim që ato vet të identifikojnë projektet, programet e mundshme përkatëse	Vazhdimisht	Komuna,DB F ,ZKKK DBPZHR, MBPZHR, OJQ -të	Komuna , BKK, Donatorë tjerë

Objektivi 4: Inkurajimim, përgatitje dhe mbështetje për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian për përfshirjen e tyre maksimale në aktivitete agrokulturore.

Aktiviteti 4: Punësimi i përhershëm dhe i përkohshëm i komuniteteve RAE përmes projekteve sezonale dhe punësimit në sistemin publik.		Periudha	Bartës	Buxheti
		1	Veprimi 4.1 Përfshirja e krahut të punës nga komunitetet në përpjekje sezonale pastrim të ambientit, punë bujqësore, pyllëzim të pyjeve etj.	2024
2	Veprimi 4.2 Mbajtja e sesioneve- trajnimeve për aftësim dhe orientim sipas projektit dhe vendit të punës-për aftësim profesional në lami të caktuara me orientim sipas prioritetit të vendit te punës.	Vazhdimisht	MPMS, MBPZHR, Komuna , ZKKK, OJQ, ZP , DPP, DAP	BKK, donatorë tjerë
3	Veprimi 4.3 Organizimi i fushatave të vetdijësimit dhe informimit për shërbimet që ofron MBPZHR, dhe MPMS.	Vazhdimisht	MPMS, MBPZHR, Komuna , ZKKK, OJQ, ZP , DPP, DAP	
4	Veprimi 4.4 Mbledhja e të dhënave mbi numrin aktual të të regjistruarve nga tri komuniteteve pran zyrave të punësimit.	Vazhdimisht	ZKKK, ZP	
5	Veprimi 4.5 Vetdijësimi i komuniteteve rreth shërbimeve të qendrave për aftësim profesional (QAP) përmes takimeve dhe seminareve orientuese.	Vazhdimisht	MPMS, MBPZHR, Komuna , ZKKK, OJQ, ZP , DPP, DAP	BKK, donatorë tjerë

6	Veprim 4.6 Vendorsja e kriterëve të trajnimit dhe respektimi i tyre, gjinia, mosha, ekzistenca në asistencë sociale etj.	Vazhdimisht	MPMS, MBPZHR, Komuna , ZKKK, OJQ, ZP , DPP, DAP	BKK dhe donatorë tjerë
7	Veprim 4.7 Vlerësim i aftësive ekzistuese dhe organizmi i trajnimeve për aftësim profesional në përputhje me mundësitë e punësimit.	Vazhdimisht	MPMS, MBPZHR, Komuna , ZKKK, OJQ, ZP , DPP, DAP	BKK, donatorë tjerë
8	Veprimi 4.8 Përfshirje e komuniteteve RAE në projektet dhe skemat e punësimit të ndërmarrura nga donatorët (UNDP, USAID) etj.	Vazhdimisht	MPMS, MBPZHR, Komuna , ZKKK, OJQ, ZP , DPP, DAP	Donatorë

Objektivi 5 : Mundësimi i marrjes së shërbimeve sociale përmes ndarjes së informacionit, përfshirjes në skemat e ndihmës dhe ofrimit të shërbimeve në formë të barbartë dhe në përputhje me nevojat				
Aktiviteti :5 .Ofrimi i shërbimeve sociale përmes ndërgjegjësimit , informimit dhe përfshirjes në skemat ekzistuese		Periudha	Bartës	Buxheti
		1	Veprimi 5.1 Informimi i komuniteteve për mundësit e marrjes dhe llojet e shërbimeve sociale	2024 vazhdimisht
2	Veprim 5.2 Ofrimi i ndihmave sociale për komunitete jo shumicë	Vazhdimisht	Komuna , MPMS, DSHMS, ZKKK	BKK
3	Veprimi 5.3 Ofrimi i ndihmave emergjente, shlyerja e borxheve të energjisë	Vazhdimisht	MPMS, MEF, Komuna ,KEDS ZKKK	
4	Veprimi 5.4 Informimi i komuniteteve përmes bisedave , takime me komunitet jo shumicë mbi të drejtat themelore në fushën e mirëqenies sociale	Vazhdimisht	MPMS, DSHMS, NDNJ ZBGJ, ZKKK,OJQ	
5	Veprimi 5.5. Të drejtat e personave me nevoja të veçanta, masat për mbrojtjen e familjes dhe masat mbrojtëse në kodin civil	2024 vazhdimisht	MPMS, DSHMS, NDNJ ZBGJ, ZKKK, OJQ-të, Gjykatat	BKK, donatë tjerë

6	Veprim 5.6. Marrëdhëniet familjare në mes anëtarëve dhe zgjedhja e krizave në familje	Vazhdimisht	MPMS, DSHMS, NDNJ ZBGJ, ZKKK, OJQ- të, Gjykatat	
7	Veprimi 5.7.Përdorimi i mjeteve abuzive në familje, menaxhimi i rasteve dhe marrja e ndihmës nga punëtorët social	Vazhdimisht	MPMS, DSHMS, NDNJ ZBGJ, ZKKK, OJQ- të, Gjykatat	BKK, donator tjerë
8	Veprimi 5.8.Mbrojtja nga trafikimi dhe abuzimi seksual i femrave dhe fëmijëve	Vazhdimisht	MPMS, DSHMS, NDNJ ZBGJ, ZKKK, OJQ- të, Gjykatat	BKK dhe donator
9	Veprimi 5.9.Bashkëpunimi me OJQ-të dhe strehimoret për rehabilitimin e grave dhe fëmijëve që përjetojnë dhunë	Vazhdimisht	MPMS, DSHMS, NDNJ ZBGJ, ZKKK, OJQ- të, Gjykatat	BKK, donatë tjerë
10	Veprimi 5.10 Lehtësimi në obligimet komunale për familjet që nuk kanë ndihmë sociale dhe asnjë formë tjetër të të ardhurave	Vazhdimisht	Komuna MPMS, DSHMS, , ZKKK,	BKK
11	Të parashihen të gjitha donacionet dhe subvencionet që të shkohen në vendet e merituar, të kontrollohen, të menaxhohen dhe të deklarohen prej organeve kompetente, lokale, qeveritare, përfaqësuese të komuniteteve, OJQ-ve , kohë pas kohe.	Vazhdimisht	Komuna, MPMS, MMPH , ZKKK	

Banimi, infrastruktura;

Qëllimi: Krijimi i kushteve për strehim për familje të komuniteteve Rom, Ashkali, Egjiptian si dhe lehtësimi i procesit të legalizimit të vendbanimeve informale.

Objektivi: 1 Ndërtimi i shtëpive për familjet pa strehim dhe rastet sociale dhe lehtësimi i procesit të legalizimit të vendbanimeve joformale

Aktiviteti 1: Identifikimi i familjeve që nuk kanë strehim dhe adresimi i problemeve të këtyre familjeve		Periodha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 1.1 Identifikimi i familjeve që nuk kanë strehim përmes vizitave në zonat ku banojnë komunitetet jo shumicë.	Vazhdimisht	ZKKK-DSHMS	
2	Veprimi 1.2 Adresimi i problemit të strehimit të këtyre familjeve në instanca tjera komunale e qeveritare dhe identifikimi i donatorëve potencial	Vazhdimisht	ZKKK, DSHMS, MPMS, MKK, MAPL	BKK, donatorë tjerë

Objektivi 2: Lehtësimi i procesit të legalizimit të vendbanimeve informale

Aktiviteti 2: Identifikimi i saktë i vendbanimeve jo-formale në zonat ku jetojnë këto komunitete.		Periodha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 2.1 Identifikimi i vendbanimeve joformale	Vazhdimisht	ZKKK	
2	Veprimi 2.2 Lehtësimi i procesit të legalizimit përmes lehtësimit të kriterëve për legalizim dhe asistencë në përgatitjen e dokumentacionit.	Vazhdimisht	ZKKK, D.Admini-stratë	
3	Veprimi 2.3 Koordinimi i aktiviteteve në fushën e vendbanimeve, informatat me institucione të ndryshme qeveritare, vendore e ndërkombëtare.	Vazhdimisht	ZKKK	
4	Veprimi 2.4 Formimi i grupit punues për lehtësimin e kriterëve për procesin e legalizimit.	Vazhdimisht	ZKKK	
5	Veprimi 2.5 Hartimi dhe publikimi i raporteve 6 mujore të progresit të arritur në këtë fushë	Vazhdimisht	ZKKK	

Objektivi 3: Strehimi i komuniteteve jo shumicë që jetojnë në kushte të rënda dhe të papërshtatshme të banimit që të bëhet përmirësimi i kushteve dhe				
Aktivitetit 3: Zgjedhje e qëndrueshme e banimit për familjet që jetojnë në gjendje të rëndë ekonomiko-sociale		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 3.1 Përgatitja e projekt-propozimit për ndërtimin e shtëpive të atyre familjeve me gjendje të rëndë ekonomik-sociale	Vazhdimisht	ZKKK, DSHMS, MPMS, MKK, OJQ-të	BKK , Komuna, donatorë tjerë
2	Veprimi 3.2 Përgatitja e databazës me të dhëna të detajuara për familjet.	Vazhdimisht	ZKKK, DSHMS, OJQ-të	
3	Veprimi 3.3. Përzgjedhja dhe vendosja e familjeve sipas udhëzimit dhe programit për banim social	Vazhdimisht	ZKKK, DSHMS	BKK Komuna , donatorë
4	Veprimi 3.4 Të identifikohen familjet me shumë anëtarë, familje me një prind, dhe ato me individë me nevoja te veqanta që të përfitojnë më lehtë përmes propozimit nga komisioni.	Vazhdimisht	ZKKK, DSHMS	

Objektivi 4: Strehimi i komuniteteve jo shumicë që jetojnë në kushte të rënda dhe të papërshtatshme për banim që të bëhen projekte për përmirësimin e kushteve për banim dhe strehim				
Aktiviteti 4. Përmirësimi i kushteve të strehimit, qasje dhe përfshirje të komuniteteve jo shumicë në programet e strehimit-vendbanimit.		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 4.1 Ndërmerren aktivitete për identifikimin e familjeve jo shumicë që banojnë në kushte të rënda banimi	Vazhdimisht	ZKKK, DSHMS, OJQ-të	
2	Veprimi 4.2 Hartimi i projektit për përmirësimin e kushteve të banimit mbi bazën e rekomandimeve të dala nga studimi, rregullimi i infrastrukturës rrugore, trotuareve, ndriqimeve, rrjeti i ujësjellësit, rrjeti i kanalizimit, rrjeti i energjisë elektrike, i shërbimeve publike etj. Për të gjitha këto të bëhen kërkesat dhe hartimi i projekteve përmes përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë në drejtoritë përkatëse komunale.	Vazhdimisht	ZKKK, DPZHE, DSHMS, DSHPMSH ,DPUMH	Donator
3	Veprimi 4.3 Përfshirja e komuniteteve përmes përfaqësuesve të tyre politik, OJQ-ve dhe dialogut të drejtëpërdrejtë me komunitetin në hartimin e planeve për strehim të ndërmarra nga niveli qendror dhe lokal.	Vazhdimisht	Komuna, ZKKK , OJQ, DSHMS, DSHPMSH MAPL, MKK , MPMS	Donatorë tjerë

Objektivi 5: Rregullimi i vendbanimeve joformale nga Qeveria e Kosovës, Komuna të ofron zgjedhje të qëndrueshme dhe trajtim të barabartë për komunitetet jo shumicë.

Aktiviteti 5. Hartimi dhe zbatimi i planeve për rregullimin e vendbanimeve informalen ekzistuese		Periudha	Bartës	Buxheti
		1	Veprimi 5.1 Hartimi i strategjisë dhe planit të veprimit për identifikimin e vendbanimeve joformale	Vazhdimisht
2	Veprimi 5.2 Hartimi i strategjisë dhe planit të veprimit për rregullimin e vendbanimeve joformale	Vazhdimisht	MMPH	
3	Veprim 5.3. Zbatimi i planit për identifikimin e vendbanimeve joformale	Vazhdimisht	MMPH , Komuna	BKK
4	Veprimi 5.4. Përmirësimi i ambientit për zhvillim të qëndrueshëm lokal	Vazhdimisht	DPZHE ZKKK	BKK, Komuna
5	Veprimi 5.5 Zhvillimi i resurseve njerëzore dhe rritja e punësimit	Vazhdimisht	MPMS, ZP, ZKKK	BKK
6	Veprim 5.6 Përmirësimi i infrastrukturës, mjedisi dhe shërbime publike	Vazhdimisht	Komuna	BKK

Objektivi 6: Strehimi dhe vendbanimi joformal				
Aktiviteti 6. Të bëhet zgjedhja e qëndrueshme për legalizim të vendbanimeve informale në ato vende që jetojnë komunitetet jo shumicë				
		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 6.1 Duhet të krijohen lehtësira në procesin e legalizimit të vendbanimeve informale nga komuna për rregullimin e dokumentacionit të pronave në ato raste kur prona nuk është në emër të tyre.	Vazhdimisht	Komuna, D. Administratë, DPKGJ, ZKKK	
2	Veprimi 6.2 Të shikohet edhe mundësia për dhënien e ndonjë prone publike për ato familje të komuniteteve jo shumicë që nuk kanë pronë dhe jetojnë në gjendje të rëndë ekonomike dhe kanë shumë nevojë për strehim.	Vazhdimisht	Komuna, MPMS, MMPH, ZKKK	

Mediat, kultura, rinia, sporti;

Objektivi: 1 Krijimi i mundësive për qasje të qytetarëve nga radhët e komuniteteve në radiot lokale dhe televizionet publike.				
Aktiviteti 1: Krijimi i mundësive financiare për zhvillimin e programeve radio dhe televizive që i dedikohen problematikave me të cilat përballen komunitetet rom, ashkalinj dhe egjiptian .				
		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 1.1 Vazhdimisht të bëhet informimi i komuniteteve që të marrin pjesë në të gjitha debatet publike me qytetarë, ku mund të debatojnë dhe t'i shpalosin kërkesat e tyre.	Vazhdimisht	Komuna, ZKKK, Drejtoria e Administratës etj	
2	Veprimi 1.2 Komunikimi me radio lokale për realizimin e një emisioni për të rinjtë që i dedikohen të rinjëve nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.	2024 vazhdimisht	MKRS, ZKKK, K, DKRS, OJQ	

3	Veprimi 1.3 Shpërndarja e informacioneve të rëndësishme, veçanërisht për takimet publike të planifikimit buxhetor dhe vendosjes së prioriteteve për investime kapitale në vendbanimet ku më së shumti frekuentojnë banorët e këtyre komuniteteve si. Psh. Qendra-Podujevë, lagja "Ali Ajeti" , lagja "Xhafer Meta", fshatrat Orllan, Batllavë, Sfeçël, Peran	Vazhdimisht	Komuna , ZKXXX, DBF, DPUMH, DPZHE	
4	Veprimi 1.4. Promovimi i Ligjit për qasje në dokumente zyrtare në zonat ku banojnë komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian me qëllim të njoftimit për të drejtat e qasjes në informacionin dhe dokumentacionin zyrtar	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , ZKXX, D. Administratë	
5	Veprimi 1.5 Të shikohet mundësia e themelimit dhe përkrahjes së një qendre mediale të qëndrueshme për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian.	2024	MKRS, Komuna, ZKXX, OJQ-të	donatorë tjerë
6	Veprimi 1.6 Mbajtja e kurseve për gazetari për pjestarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian me qëllim të ngritjes së tyre ideore e profesionale dhe të përfitimit në këtë fushë.	Vazhdimisht	ZKXX, OJQ-të ,	BKK, donatorë tjerë

Objektivi:2 Rritja e pjesëmarrjes rom, ashkali dhe egjiptian në procesin e vendim-marrjes për politikë, hartimi dhe zbatimi në fushën e kulturës dhe mediave në të gjitha nivelet				
Aktiviteti: 2 Rritja e kapaciteteve të anëtarëve të tri komuniteteve për mes aktiviteteve të edukimit formal dhe joformal				
	Periodha	Bartës	Buxheti	
1	Veprimi 2.1 Ofrimi i mundësive për kryerjen e praktikave mësimore, studentëve jo shumicë pran institucioneve kulturore në baza të rregullta periodike.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna, D. e Administratës, DKRS, ZKKK	BKK,
2	Veprimi 2.2 Ofrimi i trajnimeve për përfaqësues të komuniteteve dhe aftësimi i tyre në përdorimin e pajisjeve teknike, polika, editoriale, gazetari, menaxhim informacioni dhe komunikimi.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , ZKKK	
3	Veprimi 2.3 Mbështetje për aktivitete për ndërtim kapacitetesh për gazetari nga tri komunitetet.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , ZKKK	BKK, donatorë tjerë
4	Veprimi 2.4 Të nxiten mediat publike dhe ato private për krijimin e programeve të veçanta dhe rritjen e fizibilitetit dhe prezentimin e jetës së tri komuniteteve në programet lokale dhe televizive.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , ZKKK, QJQ	BKK, donatorë tjerë
5	Veprimi 2.5 Monitorimi i rregullt i mediave të shkruara dhe elektronike dhe ofrimi i raporteve analitike çdo fund viti mbi vendin që tri komunitetet zënë në hapësirat mediale.	Vazhdimisht	MKRS, DKRS, Drejtori e	BKK, donatorë tjerë

Objektivi: 3 Promovimi i identitetit kulturor të tri komuniteteve përmes mbrojtjes së trashigimisë kulturore dhe mbështetjes së aktiviteteve kulturore.				
Aktiviteti: 3 Ndërgjegjësimi i publikut mbi pasurinë kulturore të tri komuniteteve përmes aktiviteteve promovuese të kulturës së tri komuniteteve.		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 3.1 Aktivitetet kërkimore për identifikimin e objekteve kulturore nga të tri komunitetet	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , DKRS, ZKKK	BKK, donatorë tjerë
2	Veprimi 3.2 Identifikimi i objekteve kulturore dhe shpallja e tyre si pasuri kombëtare.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , DKRS, ZKKK	
3	Veprimi 3.3 Publikimi dhe rritja e dijenisë publike mbi objektet e trashëgimisë kulturore.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , DKRS, ZKKK	
4	Veprimi 3.4 Mbështetja për mbledhjen faktografike për kulturën muzikën, artin e tri komuniteteve.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , DKRS, ZKKK-OJQ	
5	Veprimi 3.5 Identifikimi i artistëve nga tri komunitetet, dhe marrja e masave për kyqjen e tyre aktive në jetën kulturore.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , DKRS, ZKKK	
6	Veprimi 3.6 Organizimi i javës së kulturës rom, ashkali dhe egjiptian.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , DKRS, ZKKK,OJQ	BKK, donatorë tjerë

Qëllimi: 4. Komunitetet rom, ashkali dhe egjpitase mund të zhvillojnë dhe promovojnë identitetin e tyre kulturor dhe zhvillimin e aktiviteteve rinore dhe sportive.				Objektivi: 4
Përmirësimi i infrastrukturës dhe mundësive financiare				
Aktiviteti: 4. Komuna të ofrojë hapsirë për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive				
1	Veprimi 4.1 Komuniteti jo shumicë ta kenë në dispozicion Qendrën Rinore për aktivitete kulturore, rinore dhe sportive.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna, DKRS, ZKKK,	
2	Veprimi 4.2 Përkrahja financiare të iniciativave kulturore dhe sportive që vijnë nga komunitete.	Vazhdimisht	Komuna, DKRS, ZKKK, OJQ-të	BKK, donatorë tjerë
3	Veprimi 4.3 Përkrahje financiare për shënimin e dy festave kombëtare të komuniteteve RAE 15 shkurt-it dhe 8 Prill-it.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna, DKRS, ZKKK, DBF	BKK, donatorë tjerë
4	Veprimi 4.4 Komunitetet RAE të inkurajohen në pjesëmarrje aktive në sporte në të gjitha klubet sportive që janë hapura për të gjithë rinjtë që kanë talent në sporte që të jenë pjesë aktive e të gjitha klubeve sportive në komunën tonë, si p.sh: klubet, futboll, basketboll, volejbol, hentboll, karate, not. etj.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna, DKRS, ZKKK,	
5	Veprimi 4.5 Të përkrahen dhe të ndihmohen të rinjtë e komuniteteve jo shumicë në komunën tonë që të jetë model për promovimin e vlerave multikulturore si në sport, kulturë, art, muzikë etj.	Vazhdimisht	Komuna, DKRS, ZKKK, OJQ-të	
6	Veprimi 4.6 Në vazhdimësi të promovohet dhe mbrohet identiteti dhe pasuritë kulturore të komuniteteve jo shumicë në të gjitha fushët e kulturës.	Vazhdimisht	Komuna, DKRS, ZKKK, OJQ-të	BKK, donatorë tjerë

<p>Qëllimi:5 Mbrojtja dhe promovimi i identitetit dhe pasurisë kulturore të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian</p> <p>Objektivi 5: Rritja e pjesëmarrjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në procesin e vendim-marrjes për politikë- hartimin dhe zbatimin në fushën e e medias, kulturës, rinisë, sportit në të gjitha nivelet.</p>				
<p>Aktiviteti: 4 Krijimi i një Komiteti të përbashkët për media, kulturë, rini dhe sport dhe mbikqyrja e projekteve për këto tri komunitete.</p>		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 5.1 Vendosija e kriterëve për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit me pjesëmarrjen e personaliteteve nga fusha e artit, kulturës, sportit nga tri komunitetet.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , DKRS, ZKKK, OJQ-të	
2	Veprimi 5.2 Anëtarët e komitetit vendosin mbi rregullat e funksionimit të tij dhe mbajnë takime të rregullta periodike mbi planifikimin dhe përcjelljen e aktiviteteve sipas planit të punës.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , DKRS, ZKKK, OJQ-të	
3	Veprimi 5.3 Komiteti ofron rekomandime mbi buxhetin për komunitete dhe prioritetet për këto aktivitete kulturore, si dhe raportimi i pasqyrave të shpenzimeve.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , DKRS, ZKKK, OJQ-të	

PS.

Hartimi dhe publikimi i këtij plani të veprimit është mbështetur nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim European OSBE

*Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, Komuna e Podujevës,
Njësi për të Drejtat e Njeriut dhe Barazia Gjinore dhe
Komiteti Komunal Veprues.*